VENDIM
Nr.7, datë 9.3.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar	i "	"
Fehmi Abdiu	Anëtar	i "	"
Kujtim Puto	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 11.11.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24/10 Akti që i përket:

KËRKESË: Qemal Driza, i biri i Aliut, datëlindja 1950, banues në Tiranë, kompleksi "Halili", shk.E, kati 5 - i përfaqësuar nga avokat Avni Shehu – me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Hamid Driza, i biri i Aliut, datëlindja 1945, banues në Tiranë, rr. "Ali Demi", p.261, shk. 4, ap. 47, i përfaqësuar nga avokat Alket Hyseni - me prokurë të posaçme.

Sali Driza, biri i Aliut, datëlindja 1941, banues në Tiranë, rr. "Elbasanit", p.4, shk. 3, ap. 20, i përfaqësuar nga avokat Alket Hyseni - me prokurë të posaçme.

Dije Kazazi (Driza), e bija e Aliut, banuese në Tiranë, rr. "Ali Demi", nr.18.

Fatbardha Ruci (Driza), e bija e Aliut, banuese në Tiranë, rr. "Gani Domi", p. 3, shk. 1, ap. 7.

OBJEKTI: 1. Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Pezullimin e këtij vendimi deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

BAZA LIGJORE: Neni 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës; neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi Qemal Driza është palë në një konflikt me karakter pasuror me subjektet e interesuara, të cilët janë të gjithë fëmijë të të ndjerit Ali Driza. Ky i fundit, ka pasur në pronësi të tij, disa prona të paluajtshme, të cilat nëpërmjet kontratave të hartuara në vitin 1991, 1993 dhe 1994 ia ka dhuruar kërkuesit. Subjektet e interesuara, duke pretenduar për disa parregullsi ligjore të dokumentacionit që e ka bërë kërkuesin pronar të vetëm të pasurisë, i janë drejtuar gjykatës, me padi me objekt *"detyrimin e të paditurit të njohë edhe ata si bashkëpronarë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të regjistrimit të një akti njoftunie dhe të kontratave përkatëse të dhurimit"*.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.3984, datë 20.6.2005, ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pa mbështetur në ligj dhe prova*".

Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të personave të interesuar, me vendimin nr. 1035, datë 2.10.2006 ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së*

Parë Tiranë".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pas rekursit të bërë nga subjektet e interesuara Hamid e Sali Driza, me vendimin nr. 166, datë 6.3.2008, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimin nr. 1035, datë 2.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësve duke u detyruar i padituri Qemal Driza t'i njohë bashkëpronarë sipas pjesëve që trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit.*"

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka kundërshtuar si antikushtetues vendimin nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime kryesore:

- Në gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk janë respektuar nenet 472 e 485 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat lidhen me kompetencën. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka rivlerësuar provat e marra gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit, duke i ndryshuar rrethanat e çështjes. Duke vlerësuar si të falsifikuar apo të pavërtetë nënshkrimin e palëve në kontratë, nga një vështrim pamor dhe pa iu nënshtruar më parë ekspertimit ligjor, Gjykata e Lartë ka marrë kompetencat që i përkasin ekspertit;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij, duke e zgjidhur çështjen në themel, ka dalë jashtë kërkimeve të palëve, pasi është shprehur për pavlefshmërinë e një kontrate dhurimi të vitit 1998, që nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, ndërkohë që nuk është shprehur për të gjithë objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka që është kërkuar në gjykim;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e sigurisë juridike, sepse nuk ka marrë në konsideratë dy vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilët vërtetonin pronësinë e kërkuesit mbi pronat, objekt shqyrtimi;

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jo logjik. Sipas kërkuesit citohen paragrafë të veçantë që kundërshtojnë njëri-tjetrin, ku nga njëra anë pranohet se dhuruesi nuk ka qenë pronar dhe nga ana tjetër detyrohet të njohë pronësinë mbi të padituri.

Përfaqësuesi i subjekteve të interesuara, Hamid e Sali Driza, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar :

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka administruar prova të reja. Është në kompetencën e Gjykatës së Lartë të bëjë vlerësimin e fakteve dhe të normave juridike, si dhe të verifikojë zbatimin dhe interpretimin e ligjit. Argumentet e parashtruara në vendimin e Gjykatës së Lartë tregojnë për keqinterpretimin, mënjanimin apo zbatimin e gabuar të dispozitave materiale dhe procedurale të kryer nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

- Gjykata nuk ka cenuar parimin e disponibilitetit të palëve, për arsye se gjykata ka shpallur kontratat e dhurimit si absolutisht të pavlefshme, për shkak të kërkimit të bërë nga vetë paditësit.

- Pretendimi i kërkuesit për alogjizmin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i pabazuar. Nga citimet e vetë kërkuesve rezulton se Ali Driza ka qenë kërkues dhe pretendues për këto prona, ndaj nuk mund të bënte tjetërsimin e tyre para daljes së vendimit të komisionit të kthimit të pronave, moment në të cilin është bërë pronar me të drejta të plota.

- Nuk qëndron pretendimi për cenim të parimit të sigurisë juridike. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë ndërhyrje në dy vendimet gjyqësore të vitit 1991. Objekt i këtij gjykimi nuk kanë qenë këto vendime gjyqësore, por vetëm kontratat e dhurimit. Të dy vendimet gjyqësore, me anë të të cilave është detyruar ish-ndërmarrja shtetërore, që nuk kishte të drejtën e tjetërsimit të pronës shtetërore kanë qenë të paekzekutueshme dhe nuk përbënin detyrim ndaj shtetit.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Dije Kazazi (Driza), ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar :

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka ndryshuar rrethanat e çështjes dhe nuk ka bërë rivlerësim të provave të marra nga gjykata e shkallës së parë dhe e apelit. Duke konstatuar se faktet dhe rrethanat e çështjes nuk nxjerrin përfundime ligjore si ato të pranuara nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, Kolegji Civil ka arritur në përfundimin, se kontratat e dhurimit janë absolutisht të pavlefshëm si në përmbajtje, ashtu edhe në formë.

- Arsyetimin e vendimit të tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka të bazuar në ligj. Nxjerrja e konkluzionit për alogjizmin e një vendimi gjyqësor nuk mund të arrihet duke shkëputur pjesë të veçanta të tij në mënyrë subjektive.

II

1. Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në fillim të seancës plenare, Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata), pasi dëgjoi pretendimet e palëve për kërkimin që lidhet me pezullimin e vendimit nr. 166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendosi rrëzimin e kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se zbatimi i tij nuk rezulton të pasohet nga cenime të interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të "gjykatës së caktuar me ligj".

Në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës kërkuesi i referohet rregullimit kushtetues të parashikuar në nenet 42 dhe 131, shkronja "f" të Kushtetutës, të cilat lidhen me respektimin e standardit *"të gjykatës së caktuar me ligj"*, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 166, datë 6.3.2008 ka tejkaluar kompetencat e parashikuara nga ligji procedural civil, pasi nëpërmjet rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit, ka ndryshuar rrethanat e çështjes. Në këtë proces gjyqësor, Kolegji Civil ka marrë gjithashtu edhe kompetencat e ekspertit kur ka vlerësuar si të falsifikuar e të pavërtetë nënshkrimin e dhuruesit në kontratat e dhurimit të pronës objekt gjykimi.

Gjykata thekson se shqyrtimi i çështjes nga një *"gjykatë e caktuar me ligj"* është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Termi *"gjykatë"* karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (shih vendimin nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vlerëson se kompetenca për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata e Lartë nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Kompetencat e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë të parashikuara në nenet 472 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta, mbi një analizë tërësore të të gjitha provave dhe rrethanave të çështjes. "Neni 485 i Kodit të Procedurës Civile i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si edhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave të instancave më të ulëta, por nuk i ka dhënë të drejtë, që mbi bazën e vlerësimit të provave, të prishin të dy vendimet e të rrëzojnë kërkesë padinë dhe as t'i ndryshojnë ato duke vendosur rrëzimin e padisë. (*shih vendimi nr.31, datë 1.12.2005*).

Në jurisprudencën e Gjykatës është konkluduar se "nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë." Sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ky kolegj ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta. (*shih vendimin nr.17, datë 30.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të mbahet i njëjti qëndrim lidhur me parregullsinë e procesit ligjor kur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prish vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit.

Nisur nga natyra e veçantë e këtij gjykimi, Gjykata thekson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka kompetencën të konkludojë për provat, duke u nisur nga një tjetër vlerësim që kanë bërë gjykata e shkallës së parë dhe e apelit. (*shih vendimi nr.31, datë 1.12.2005*). Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe e apelit dhe pa i ndryshuar ato.

Duke analizuar rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka

konkluduar ndërmjet të tjerave se:*"... faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë ashtu siç i kanë pranuar apriori të dy gjykatat e faktit"*. Ky kolegj ka konkluduar se "*është shpronësuar prona e Ali Drizës"*, ndërkohë që për të njëjtin fakt në vendimin e gjykatës së apelit "*rezulton se nuk kanë qenë të shpronësuara"*.

Këto deklarime të Kolegjit Civil, pasohen nga analiza e fakteve dhe e rrethanave, e ndryshme nga ajo që kanë bërë gjykatat më të ulëta. *"Në kundërshtim me sa kanë pranuar dy gjykatat e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, analizon faktet dhe rrethanat"* duke vënë në dyshim vërtetësinë e nënshkrimit në kontratat e dhurimit të hartuara përpara noterit. Gjykata thekson se lindja e çdo dyshimi të arsyeshëm mbi vërtetësinë e nënshkrimit në aktet objekt shqyrtimi nuk i jep të drejtë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të konkludojë mbi falsitetin apo pavërtetësinë e dokumentit, pa u shprehur më parë eksperti për një çështje të tillë. Bazuar mbi një vlerësim të ndryshëm të provave dhe të fakteve që janë dhënë nga gjykata e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, duke pranuar padinë e paditësve.

Në kërkesë është pretenduar gjithashtu si një argument për parregullsinë e procesit gjyqësor edhe mosmarrja në konsideratë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që vërtetonin pronësinë e kërkuesit mbi pronat objekt gjykimi. Siç rezulton nga dosja gjyqësore, nëpërmjet dy vendimeve nr. 1176, datë 18.06.1991 dhe nr. 2222, datë 19.10.1991 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me objekt të padisë rivendikimin e sendit, trashëgimlënësi i kërkuesit, në cilësinë e pronarit të disa pronave të pashpronësuara, ka kërkuar nga ish-ndërmarrja shtetërore kthimin e tyre. Pikërisht, bazuar mbi këto fakte e rrethana kanë vendosur zgjidhjen e çështjes gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, ndërkohë që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke mënjanuar zbatimin e të dy vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ka konkluduar se *"këto vendime gjyqësore nuk ishin të ekzekutueshme."*

Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksohet se shteti i së drejtës, i cili garantohet që në preambulën e Kushtetutës sonë, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Një nga elementet më esencialë të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, i cili kërkon, midis të tjerash, që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim. (*shih vendimi nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese dhe çështjen* "Brumărescu kundër Rumanisë"; vendim i datës *28.10.1999 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut).*

Gjykata thekson se të dy vendimet gjyqësore të cilave nuk u është referuar Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e çështjes janë në fuqi dhe si të tilla mbeten të detyrueshme për t'u zbatuar në çdo kohë. Duke marrë një vendim në tejkalim të kompetencave të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, Gjykata konkludon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të gjykatës së *"caktuar me ligj"*.

3. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të disponibilitetit

Kërkuesi pretendon se Kolegji Civil ka cenuar parimin e disponibilitetit, pasi në vendimin e tij nuk është shprehur për të gjithë objektin e mosmarrëveshjes dhe për gjithçka që është kërkuar nga pala paditëse në objektin e padisë.

Parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Iniciativa për të filluar procesin i takon palës së interesuar, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari - *"Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe" (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile).* Në çdo rast është pala që tregon objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë. Pra *"gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet" (neni 6 i Kodit të Procedurës Civile).*

Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. "Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elemente thelbësore që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut" (Shih

vendimin nr.20, datë 2.7.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka qënë në pozitën procedurale të të padituri, ndërkohë që ka qenë paditësi ai që ka ushtruar të drejtën e tij për rekurs në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se, përderisa objekti i gjykimit është përcaktuar nga kërkimet e palës paditëse, (nenet 6 dhe 16 të Kodit të Procedurës Civile) kërkuesi nuk legjitimohet ratione personae.

4. Lidhur me pretendimin për mos arsyetimin e vendimit gjyqësor

Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke argumentuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dhënë një vendim kontradiktor dhe jologjik. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. "Gjyqësori, në kryerjen e funksioneve i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (neni 142)... Kodi i Procedurës Civile parashikon, se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë... Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse. Dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve"(*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka theksuar se: "Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik" (*shih vendimi nr.33, datë 8.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata vlerëson se vijueshmëria logjike e arsyetimit konstatohet nga leximi integral i vendimit dhe nuk mund të deduktohet nga pasazhe të shkëputura. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se të dy paragrafët e sjellë nga ana e kërkuesit si argumente të arsyetimit jo logjik të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë pjesë të shkëputura nga kontekste të ndryshme. Ndërsa i pari i referohet aktit të njohjes së pronësisë nga një vendim i komisionit të kthimit të pronave të vitit 1994, citimi i dytë i referohet dy kontratave të dhurimit të lidhura respektivisht në vitet 1991 dhe 1993. Nga kjo pikëpamje, pretendimi i kërkuesit për një arsyetim jologjik e kontradiktor të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i pabazuar.

Përfundimisht Gjykata konkludon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit lidhur me konceptin *"gjykatë e caktuar me ligj"*, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.166, datë 6.3.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Vitore Tusha
Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), (Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Kujtim Puto

MENDIM PAKICE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.166, datë 6.3.2008 ka ndryshuar vendimet nr.1035, datë 2.10.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.3984, datë 20.6.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar padinë e subjekteve të interesuara Sali Driza dhe Hamid Driza dhe duke detyruar kërkuesin Qemal Driza t'i njohë ata bashkëpronarë sipas pjesëve që trashëgojnë nga pasuria e trashëgimlënësit Ali Driza.

Shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kundërshtim me qëndrimin e shumicës, jemi të mendimit se vendimi i Kolegjit Civil nuk duhej shfuqizuar si antikushtetues.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ajo e Apelit Tiranë, në vendimet e tyre, kanë pranuar ndër të tjera se i ati i ndërgjyqësve, Ali Driza, ka pasur në pronësi disa objekte si: truall me sipërfaqe 867 m^2 me dyqane, banesë etj., qysh para vitit 1944. Për këto prona, pas vitit 1990 ai ka bërë disa kontrata me të cilat ia ka kaluar gjithë pronësinë njërit prej fëmijëve të tij, kërkuesit Qemal Driza. Gjykatat kanë pranuar gjithashtu se Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave i ka kthyer trashëgimlënësit Ali vetëm sipërfaqen e shtetëzuar prej 192 m^2, ndërsa pjesa tjetër prej 627 m^2, me gjithë ndërtesat, nuk i është kthyer me vendim të Komisionit, por me dy vendimet gjyqësore të vitit 1991, që detyronin për këtë kthim Ndërmarrjen Tregtare të Ushqimit Social.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Kolegji), në ndryshim nga gjykatat e mësipërme ka pranuar se trashëgimtarit të palëve nuk i është kthyer sipërfaqja prej 627 m^2 në vitin 1991 me vendimet e gjykatave, sepse këto të fundit, sipas atij Kolegji, ishin të paekzekutueshme. Kolegji vlerësoi se meqë Ndërmarrja Tregtare nuk ishte disponuese e pronës shtetërore, duhet pranuar se pronat janë kthyer vetëm me vendim të Komisionit në vitin 1994. Kolegji Civil ka pranuar gjithashtu se kontratat me të cilat ka kaluar pronësia nga trashëgimlënësi te kërkuesi janë veprime juridike absolutisht të pavlefshme sepse, duke qenë me të meta thelbësore në përmbajtje dhe formë, ato vijnë në kundërshtim me ligjet dhe aktet nënligjore të kohës.

Lidhur me vlerësimet për vlefshmërinë e kontratave të kalimit të pronësisë, Kolegji nuk ka dalë jashtë kompetencave të veta dhe as i ka cenuar kërkuesit të drejtën e mbrojtjes. Kolegji Civil ka pranuar ekzistencën e kontratave dhe, në përputhje me kërkesat e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë interpretimin juridik të formës e përmbajtjes së kontratave të dhurimit në favor të kërkuesit dhe ka pranuar se nuk është respektuar ligji. Në përfundim, ai i ka konsideruar ato të pavlefshme dhe, si të tilla, nuk mund të shërbenin si bazë për kalimin e pronësisë vetëm te kërkuesi. Si rrjedhojë, janë njohur si bashkëpronarë të gjithë trashëgimtarët dhe jo vetëm kërkuesi.

Vendimi i mësipërm i Kolegjit Civil nuk ka cenuar elementet e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Funksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës kërkon që Gjykata e Lartë së pari, të aplikojë të drejtën mbi faktet e konstatuara e të vlerësuara në mënyrë të pavarur nga gjykatat e rrethit e të apelit dhe, së dyti, të njësojë praktikën gjyqësore në bazë të interpretimit që u jep problemeve juridike, pra të interpretojë ligjin për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë territorin *(vendimi nr.31, datë 1.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese)*.

Në çështjen në shqyrtim Gjykata e Lartë ka ushtruar funksionin e saj rishikues, duke i dhënë vlerësim tjetër juridik rrethanave e fakteve të çështjes. Përmendja në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë se ai kolegj "vëren se faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë ashtu siç i kanë pranuar apriori të dy gjykatat e faktit", nuk ka ndikim thelbësor në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit. Kjo sepse edhe për faktet që Kolegji Civil i ka pranuar sipas konkluzioneve të gjykatës së

rrethit e të apelit, interpretimi juridik i bërë prej tij ka determinuar në ndryshimin e vendimit të atyre gjykatave dhe pranimin e subjekteve të interesuara si bashkëpronarë në pasurinë e trashëgimlënësit.

Anëtar: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Petrit Plloçi.